

- 1. Pyetje:** A mund të aplikojnë në grant programin edhe shkollat vetëm me arsim trevjeçar profesionale, gjegjësisht a mund të aplikojnë shkollat me projekte që kanë të bëjnë me lëmit që mësohen vetëm 3 vjet? **Përgjigje:** Ky projekt ka të bëjë vetëm me arsimin profesional katërvjeçar, gjegjësisht arsimin teknik.
- 2. Pyetje:** A mund edhe shkollat e artit të aplikojnë në grant programin? **Përgjigje:** Jo, ky projekt ka të bëjë vetëm me arsimin profesional katërvjeçar, gjegjësisht arsimin teknik.
- 3. Pyetje:** A mund të blihen kafshë me mjetet nga grantet? **Përgjigje:** Jo.
- 4. Pyetje:** A mund të blihen bimë me mjetet nga grantet? **Përgjigje:** Po.
- 5. Pyetje:** A duhet puna praktike në kompaninë reale shkollore të përfshihet me planin mësimor? **Përgjigje:** Po, puna praktike në kompaninë reale shkollore duhet të përfshihet në programin mësimor ose të zhvillohet si aktivitet jashtë-arsimor, por në asnjë rast nuk duhet mos të realizohet plani mësimor.
- 6. Pyetje:** Çfarë përfshihet me shpenzimet për trajnim? **Përgjigje:** Shpenzimet e ndërlidhura me vizita pune, shpenzime për organizim të seminareve, punëtorive dhe aktiviteteve tjera të ndërlidhura me trajnimin, shpenzime për prokurim të materialeve për organizim të trajnimeve, qiramarrje të hapësirës dhe pajisjes, shpenzime rruge, akomodim dhe mëditje për trajnuesit dhe pjesëmarrësit, kompensime për trajnuesit dhe shpenzime tjera të ndërlidhura me trajnimin që aplikanti duhet ti parasheh në propozim projekt.
- 7. Pyetje:** A mund të prokurohet pajisje për nevojat e shkollës prej kompanive të jashtme? **Përgjigje:** Po, por në atë rast firma duhet të hap llogari jorezidente, pasi pagesa kryhet në denarë.
- 8. Pyetje:** A mund të dërgohen nxënësit në punë praktike jashtë vendit tonë? **Përgjigje:** Qëllimi i programit është të përforcohet bashkëpunimi mes shkollave të mesme publike profesionale dhe komunitetit afarist këtu në vendin tonë, pasi kompanitë dhe ndërmarrjet e vendit janë në të vërtetë punëdhënësit e ardhshëm të nxënësve tonë.
- 9. Pyetje:** A mundet vetëm firmë private të paraqitet në rol të partner kompanisë ose mund të jetë edhe firmë shtetërore/ndërmarrje publike? **Përgjigje:** Firmë shtetërore/ndërmarrje publike mund të paraqitet si partner kompani vetëm nëse vlerësohet se është financiarisht dhe ligësisht e pavarur, punon sipas ligjeve tregtare dhe nuk është agjenci e lidhur/varur prej Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose shkollës.
- 10. Pyetje:** A mund të aplikohet për masën 1.1. me kompani reale shkollore që vetëm më ekziston? **Përgjigje:** Jo, grant masa 1.1 është për themelim të kompanive reale shkollore të reja.

- 11. Pyetje:** A mbetet pajisja në pronë të shkollës pas përfundimit të projektit? **Përgjigje:** Po, shkolla është pronare e pajisjes pas përfundimit të projektit.
- 12. Pyetje:** A mundet të angazhohet person nga partner kompania në kompaninë reale me kontratë konsulenti? **Përgjigje:** Jo, të punësuarit në partner kompaninë duhet të bashkëpunojnë me shkollat në bazë të bashkëpunimit paraprak mes shkollës dhe partner kompanisë për dorëzim të aplikacionit të përbashkët për grant, gjegjësisht në bazë të marrëveshjes trepalëshe për grant që nënshkruajnë Ministria e arsimit dhe shkencës, shkolla dhe partner kompania..
- 13. Pyetje:** A mund të angazhohet person i punësuar në shkollë me anë të kontratës për konsulentë në kompaninë reale? **Përgjigje:** Jo.
- 14. Pyetje:** A mundet kompania reale fizikisht të vendoset në hapësirat e partner kompanisë? **Përgjigje:** Mundet, por shkolla mban përgjegjësi për punën dhe mjetet materiale që janë të pronë të kompanisë reale shkollore.
- 15. Pyetje:** A mund të bëhet ridrejtim i mjeteve, nëse vlera e përcaktuar e aplikacionit dhe marrëveshjes nuk përputhen me vlerësimin fillestar? **Përgjigje:** Mundet, nëse ridrejtimi është në suaza të vlerave reale të tregut dhe prokurimeve dhe vlerësimeve të parapara, sipas qëllimit fillestar të mjeteve për grant.
- 16. Pyetje:** A duhet të përfshihet TVSH në propozim projektin, gjegjësisht aplikacionin? **Përgjigje:** Shpenzimet për TVSH dhe të gjithë tatimet tjera (p.sh. tatimi personal) duhet të përfshihen në propozim buxhetin e aplikacionit.
- 17. Pyetje:** A duhet trajnuesit e ndërmarrjeve që do të punojnë me nxënësit të kenë certifikatë për mentor – trajnues? **Përgjigje:** Po, ndërmarrjet që kanë mentor-trajnues do të kenë përparësi gjatë procesit të aplikimit me propozim projekt me SHMP.
- 18. Pyetje:** A do të ketë kompensim për shpenzimet e rrugës/ushqimin gjatë trajnimeve që do zhvillohen nën mentorim të partner kompanisë? **Përgjigje:** Po, nëse kjo është paraparë në aplikacionin.
- 19. Pyetje:** A mundet të dedikohet një pjesë e mjeteve të graniti për sigurim të nxënësve nga lëndime? **Përgjigje:** Po.